



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 tetor 2012
Nr. ref.: RK310/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 43/12

SH. A "JATEX"

Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 të datës 03.05.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Cukalovic, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Shoqëria Aksionare "Jatex" me seli punë në Gjakovë Rr. "Nëna Terezë" nr.8

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik Aktvendimi i Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 të datës 03.05.2011 për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk specifikoj datën e pranimit të tij

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) me 26 prill 2012 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin u refuzua kërkesa për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e po kësaj Gjykate A.nr.1771/2005 të datës 31.10.2007

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

4. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e lartcekur i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe atë: barazia para Ligjit (neni 24), E drejta për Gjykim të Drejte dhe të paanshëm (neni 31) dhe Mbrojtja Gjyqësore e të drejtave (neni 54).

Baza juridike

5. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 i Kushtetutës, nenet 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, , dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 prill 2012, parashtruesi i Kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë me nr KI 43/12.
7. Më 22 maj me vendimin GJ.R. KI 43/12 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues, gjyqtarin Robert Carolan,ndërsa me vendimin KSH 43/12,Kolegjin shqyrtues në përbërje Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami në cilësi të anëtarëve të kolegjit.
8. Më 2 korrik 2012 VENDIM Kryetari i Gjykatës morri Vendimin për zëvendësimin e gjyqtarëve të kolegjit shqyrtues ,Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami(skadimi i mandatit ,neni 8 pika 1,1 i ligjit për Gjykatën kushtetuese) dhe në vend të tyre emëroj prof .dr. Enver Hasani, dhe Almiro Rodrigues, gjyqtar si anëtar të në Kolegjin Shqyrtues për lëndën KI 43/12
9. Me 29 maj 2012 Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe njëkohësisht ka kërkuar që të dërgojë komentet eventuale lidhur me kërkesën..

10. Me 29 maj 2012 Gjykata kishte njoftuar gjithashtu edhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës lidhur me Kërkesën e parashtruar dhe ka kërkuar përgjigjeje me shkrim.
11. Gjykata Kushtetuese nuk morri asnjë përgjigjeje dhe as një koment të shkruar nga asnjëra palë brenda afatit ligjor Me 16 mars 2012
12. me 19 shtator në seancën shqyrtuese për këtë lëndë .paneli shqyrtues i propozoj gjykatës në përbërje të plotë për pa pranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 28 shkurt 2005 ,Administrata Tatimore e Kosovës NJ/T.M –Prishtinë nëpërmes inspektorëve të autorizuar tatimor kishte përpiluar” Raportin e Kontrollit” për Subjektin Afarist H.C” Jatex” me seli pune në Gjakovë.
14. Kontrolli i referohej periudhës kohore 01.07.2001 deri më 31.12.2003 dhe pas përfundimit të tij me raportin e l sipërpërmendur Kompania “JATEX” kishte detyrim të paguaj në emër të obligimeve tatimore në formën e ndëshkimit dhe interesit shumën prej 73480.85 €.
15. Më 05 maj 2005 SH.A ‘Jatex” kishte bërë ankesë në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore , për shkak të: 1). Vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike;2).Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe 3)vendimit mbi lartësinë e dënimit-përcaktimit zyrtar,duke kërkuar që ky departament të anuloj të gjeturat e raportit dhe ta lirojë nga obligimi financiar ndaj ATK-së.
16. Më 24. Qershor 2005 Departamenti i Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës morri vendim për Refuzimin e ankesës së SHA”Jatex” nga Gjakova me arsyetimin se Inspektorët e sajë kishin konstatuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike dhe se ndëshkimet dhe interesi i caktuar për SH.A “Jatex” rrjedhin sipas nenit 5 të procedurave të parapara me rreg. e Unmik-ut nr 2000/20 mi Mbi Administratën dhe Procedurat tatimore.
17. Kundër këtij vendimi më 30. Gusht 2005 SH.A “Jatex” ka paraqitur ankesë në Bordin e pavarur për Shqyrtimin e vendimeve të Administratës Tatimore për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim it të gabuar të së drejt[s materiale.
18. Më 01 dhjetor 2005 Bordi i pavarur për Rishqyrtime ka nxjerr Aktvendimin A.nr 389/2005 me të cilin ka refuzuar ankesën e SH.A.”Jatex” nga Gjakova dhe ka lënë në fuqi vendimin e Administratës tatimore nr 213/205 të datës 06.07.2005.

19. Kundër këtij Aktvendimi më 23 dhjetor 2005 SH.A."Jatex" ka parashtruar Padi në Gjykatën Supreme duke kërkuar anulimin e tij.
20. Më 31 tetor 2007 Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën e Konfliktit Administrativ nxori Aktgjykimin A.nr.1771/2005 dhe Refuzoi Padinë e SH.A "jatex" me arsyetimin se gjendja faktike ishte e konstatuar e drejtë dhe e plotë nga ana e organeve administrative si dhe përcaktimi i tatimeve,ndëshkimeve dhe interesave ishte bërë konform legjislacionit në fuqi.
21. Kundër këtij Aktgjykimi SH.A"Jatex" në afat ligjor parashtroi Padi për Përsëritjen e Procedurës.
22. Më 03 maj 2011 Gjykata Supreme e Kosovës mori Aktvendimin P.P.A nr 3/2008 me të cilin Hodhi Poshtë padinë për Përsëritjen e Procedurës me arsyetimin se përpos përsëritjes së pohimit për jo profesionalizimin e inspektorëve tatimor të Administratës Tatimore të Kosovës ,paditësi nuk kishte ofruar prova tjera bindëse që do të arsyetonin përsëritjen e procedurës.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e Gjykatës supreme të Kosovës me të cilin nuk i është aprovuar padia për përsëritjen e procedurës atij si subjekt afarist i është cenuare drejta e garantuar me kushtetutë për barazinë para ligjit si dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave (neni 24 dhe 54 i Kushtetutës).
24. parashtruesi kërkesë më tej ka theksuar se këto të drejta janë shkelur si pasojë e mos konstatimit të drejtë e të plotë të gjendjes faktike ,nga ana e inspektorëve tatimor të Administratës tatimore dhe jo profesionalizmit të theksuar të tyre sepse e kanë ngarkuar Kompaninë e tyre me obligime financiare ne emër të tatimeve. interesave e ndëshkimeve për shitje të cilat sipas parashtruesit të ankesës lirohen nga tatimi dhe blerësi i kishte këto mjete si kontribute dhe donacion. Sipas parashtruesit të ankesës të notat gabime i kanë bërë edhe organet administrative edhe Gjykata Supreme kur nuk i ka marrë parasysh faktet e parashtruara nga 'Jatex"SH.A.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për te gene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen ne Kushtetute,ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës
26. Ne lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

"Individët janë te autorizuar te ngrenë shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi te kenë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj."

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ku shprehimisht përcaktohet se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."

27. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda afatit katër mujor Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtruesit të kërkesës si dhe datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
28. Nga kopja e formularit standard për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese Konstatohet fakti se parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar datën e pranimit të Aktvendimit të fundit - Gjykatës Supreme por ne rubrikën ku detyrohet pa përcaktojë atë kishte vure pikëpyetje(?) duke dhënë indikacion se nuk e di kur e ka pranuar atë vendim.
29. Gjykata me këtë rast rikujton se sipas nenit 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese është obligim i paraqitësit të kërkesës ta saktësoj kërkesën dhe se ky obligim nënkupton edhe paraqitjen e dëshmimeve se kërkesa e tij-saj është brenda kornizave kohore të afatit 4 mujor të përcaktuar me ligj.
30. Në fakt edhe pse paraqitësi i kërkesës nuk kishte specifikuar datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme nga kopja e këtij Aktvendimi që e ka bashkangjitur me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, qartazi vërehet se në ballinën e Këtij Aktvendimi në anën e majtë vet paraqitësi i kërkesës(jatex korporata) i kishte vënë vulën zyrtare të protokollit të pranimit që mbanë titullin e organit pranues, nr e protokollit .191 dhe datën 15.06.2011.
31. Fakti që, Aktvendimi i Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 i nxjerrë me 03.05.2011 dhe është pranuar më 15.06.2011, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur me 26 prill 2012 .i krijon bazë të qartë juridike Gjykatës që në përputhje me rregullin 36 par 1 pika (b) të konstatojë se kërkesa është e papranueshme sepse parashtruesi i sajë e ka paraqitur atë në Gjykatë pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, një arsye të tillë ne mes tjerash Gjykata e kishte

përdorur edhe me rastin e vendosjes së kërkesës Komuna e Gjakovës - Vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Nr. c. nr. 183/2009 të 17 qershorit 2009 (Aktvendimi për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese i dt. 21 maj 2012)

32. Gjykata gjithmonë thekson se qëllimi i rregullit katër-mujor është për të promovuar sigurinë juridike, të sigurojë që rastet e ngritura për e çështjet Kushtetuese do të ë shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (shih mutais mutandis PM v Mbretëria e Bashkuar Aplikacioni no. 6638/03, 19 korrik 2005)
33. Në këto rrethana parashtruesi i kërkesë nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, andaj:

PËR KËTO ARËSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 shtatorit 2012, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani